



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 427/9 Prot.

Tiranë, më 31.05.2019

**V E N D I M**

**Nr.73, datë 19.04.2019**

**Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimine shërbimit civil në Agjencinë e Trajtimit të Konçensioneve dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative”*, Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, të miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, në Agjencinë e Trajtimit të Konçensioneve, institucion në varësi të Ministrisë Financave dhe Ekonomisë,

**VËREJ SE:**

Me vendimin nr. 28, datë 19.04.2019, *“Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimi e shërbimit civil, në Agjencinë e Trajtimit të Konçensioneve”*, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, në Agjencinë e Trajtimit të Konçensioneve (ATRAKO).

Objekti i mbikëqyrjes përfshin veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si pjesëmarrës në proceset e administrimit të shërbimit

civil, prej momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, e në vijim.

Procesi është zhvilluar në përputhje me Programin e Mbikëqyrjes me nr. 427/1 prot., datë 19.04.2019, të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i cili i është njoftuar subjektit me shkresën nr.427/2, datë 19.04.2019, “Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në Agjencinë e Trajtimit të Konçensioneve”.

Agjencia e Trajtimit të Konçensioneve është institucion qëpërfshihet për herë të parë në skemën e administrimit të shërbimit civil, pas fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, i cili evidentohet me numër rendor 13, në lidhjen nr. 1, “Lista e institucioneve të administratës shtetërore”, që është pjesë e vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, të ndryshuar.

Në përfundim të procesit të verifikimit të dokumentacionit dhe grumbullimit të të dhënave, grupi i mbikëqyrjes ka hartuar projektraportin për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil dhe ia ka dërguar për njohje subjektit të mbikëqyrur me shkresën nr. 427/5 prot., datë 28.05.2019, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, “Dërgohet projekt raporti në përfundim të mbikëqyrjes në Agjencinë e Trajtimit të Konçensioneve, në lidhje me administrimin e shërbimit civil”, duke i lënë 15 ditë kohë për të paraqitur komentet e tyre në lidhje me konstatimet e evidentuara nga grupi i mbikëqyrjes.

Me shkresat nr. 427/6 prot., datë 27.05.2019 dhe nr. 427/7 prot., datë 27.05.2019, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, “Dërgohet projekt raporti në përfundim të mbikëqyrjes në Agjencinë e Trajtimit të Konçensioneve, në lidhje me administrimin e shërbimit civil”, projekt raporti i mbikëqyrjes i është dërguar për njohje, respektivisht, Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë, që është ministria nga e cila varet institucioni i mbikëqyrur dhe Departamentit të Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse në këtë rast.

Ndërkohë, subjekti i mbikëqyrur, pasi është njohur me projektraportin dhe gjetjet e grupit të punës, me shkresën nr. 81/2 prot., datë 30.05.2019, “Në vijim të shkresës suaj nr. 427/5 prot., datë 28.05.2019.”, ka dërguar projektraportin e nënshkruar nga personat përgjegjës, duke u shprehur dakord me gjetjet e grupit të punës të pasqyruara në të.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikën e evidentuar.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij.

## **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, referuar Seksionit III, “Procedura hetimore”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

## **V E N D O S A:**

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me administrimin e shërbimit civil në Agjencinë e Trajtimit të Konçensioneve, i cili është pjesë e këtij vendimi dhe të paralajmëroj institucionin për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke kërkuar zbatimin e detyrave që do të specifikohen më poshtë.
2. Departamenti i Administratës Publike, në rolin e njësisë përgjegjëse, duhet të unifikojë kategorizimin e pozicioneve të punës në shërbimin civil, në institucionet e varësisë (në rastin konkret për pozicionin e punës “Drejtor Drejtorie”) në përputhje me kërkesat e nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Ky proces duhet të realizohet duke vlerësuar përfshirjen tyre në një prej kategorive të përcaktuara në këtë dispozitë: e lartë drejtuese, e mesme drejtuese, e ulët drejtuese dhe ekzekutive, me qëllim rritjen e transparencës si në drejtim të procesit të rekrutimit (në nivel ekzekutiv, lëvizje paralele apo ngritje në detyrë) ashtu edhe në drejtim të mënyrës së pagesës së nëpunësit civil, në përputhje me përgjegjësitë dhe detyrat që ai realizon gjatë veprimtarisë së tij.

3. Agjencia e Trajtimit të Konçensioneve, duhet t’i dërgojë zyrtarisht Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë formularin e vlerësimit të punës për titullarin e institucionit, nëpunësin \*\*\*\*\*, e cila është anëtare e TND-së, me qëllim që të përmbillet procesi i vlerësimit të rezultateve në punë, i cili nuk është realizuar në këtë rast.
4. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë, të plotësojë formularin e vlerësimit të punës dhe ta dërgojë atë pranë njësisë përgjegjëse (DAP) me qëllim që të vijojnë procedurat e parashikuara në pikën 5, të vendimit nr. 109, datë 26.02.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, indryshuar, lidhur me vlerësimin e anëtarit të TND-së, \*\*\*\*\* nga Komisioni Kombëtar i Përzgjedhjes.

5. Njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit, të përfundojë procesin e hartimit të përshkrimeve të punës, për të gjitha pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në Vendimin nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, *”Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, të ndryshuar dhe në përputhje me orientimet që janë dhënë në rubrikën përkatëse të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.

Një kopje e përshkrimeve të punës të nënshkruara krahas depozitimit në dosjen e personelit të çdo nëpunësi civil, duhet të depozitohen dhe në arkivin e institucionit si dhe pranë Departamentit të Administratës Publike.

Kjo detyrë duhet të përmbushet në vijim nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit, duke i dërguar formularët e përshkrimit të punës, pranë Departamentit të Administratës Publike, për të marrë edhe miratimin e njësisë përgjegjëse

6. Njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit, të plotësojë dosjen e personelit të çdo nëpunësi civil, duke përfshirë në të, të gjitha dokumentet dhe të dhënat sipas lidhjeve 1 e 2, pjesë e Vendimit nr. 117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”*, si dhe ato të evidentuara në mungesë në tabelën aneks nr. 2, e cila është pjesë e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.
7. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **30** ditë nga marrja dijeni për këtë vendim.
8. Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, Agjencia e Trajtimit të Konçensioneve, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Departamenti i Administratës Publike duhet të njoftojnë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
9. Për këtë vendim të njoftohet Agjencia e Trajtimit të Konçensioneve, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Departamenti i Administratës Publike.
10. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## KOMISIONERI

**Pranvera STRAKOSHA**